



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Tiranë, datë 20 / 05 / 2009

Njoftim për shtyp

Mbi Memorandumin e Mirëkuptimit mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)

Sot në mjediset e Autoritetit të Konkurrencës u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit mes këtij institucioni të përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Lindita Milo (Lati) dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të përfaqësuar nga Drejtori i saj, Z. Tomi Kola.

Nënshkrimi i këtij Memorandumi ka si qëllim shkëmbimin e informacionit për një zbatim sa më të mirë dhe efikas të ligjeve organike respektive dhe bazohet në të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" si dhe në zbatim të Ligjit 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi të ngushtë institucional është ulja reale e kostove të transaksioneve midis bizneseve.

Sipas memorandumit, palët do të bashkëpunojnë për të rritur eficiencën e mbikëqyrjes së ndryshimeve në strukturat e tregjeve dhe mbikëqyrjen e efekteve reale të tyre në sjelljen e ndërmarrjeve në treg, duke synuar mbrojtjen e konkurrencës në përputhje me Ligjin nr 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar), si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kulturës së konkurrencës.

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit, i cili ka të bëjë me regjistrimin e shoqërive që bashkohen, të shoqërive që përftojnë kontrollin e shoqërive të tjera, të çdo transaksioni që ndryshon strukturën e tregut si dhe të çdo informacioni tjetër që është i nevojshëm për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës.

Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve është shumë i rëndësishëm për të arritur në kohë reale në mbikëqyrjen e tregjeve për mbrojtjen e konkurrencës për një treg sa më eficient duke siguruar një informacion sa më të plotë për strukturat e tregjeve.

Memorandumi i Bashkëpunimit është në vazhden e marrëdhënieve e bashkëpunimit shumë të mirë midis këtyre institucioneve.. Ky memorandum do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e dy përfaqësuesve të institucioneve përkatëse.

